



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA
GJYKATA SUPREME

Numri i lëndës: 2024:049109
Datë: 20.03.2024
Numri i dokumentit: 05477339

Pml.nr.183/2024

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Afrim Shala, kryetar i kolegjit, Agim Maliqi dhe Rasim Rasimi, anëtarë, me bashkëpunëtoren profesionale Qefsere Berisha, në çështjen penale kundër të pandehurit A. Ç., për shkak të veprës penale “*Shkaktimi i rrezikut të përgjithshëm*” nga neni 356, paragrafi 1. të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), duke vendosur lidhur me kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë të mbrojtësit të të pandehurit, avokatit Arben Shala, paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prizren - Departamenti i Përgjithshëm, Ppr.nr.96/2024 të datës 13.2.2024 dhe aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, PN1DP.nr.230/2024 të datës 20.2.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur më datë 20.03.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

Hedhet si jolëndore kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë e mbrojtësit të të pandehurit A. Ç. e paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prizren - Departamenti i Përgjithshëm, Ppr.nr.96/2024 të datës 13.2.2024 dhe aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, PN1DP.nr.230/2024 të datës 20.2.2024.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Prizren - Departamenti i Përgjithshëm, me aktvendimin Ppr.nr.96/2024 të datës 13.2.2024, të pandehurit A. Ç., për shkak të veprës penale “*Shkaktimi i rrezikut të përgjithshëm*” nga neni 356, paragrafi 1. të KPRK, ia ka caktuar masën e paraburgimit në kohëzgjatje prej 1 (një) muaji, ashtu që sipas këtij aktvendimi paraburgimi do t'i zgjasë nga data 11.2.2024 deri me datën 11.3.2024. Të pandehurit paraburgimi i është caktuar konform dispozitës së nenit 184, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.1. e 1.2. pika 1.2.2., dhe 1.2.3. të Kodit të Procedurës Penale (KPP).

Në procedurën ankimore, Gjykata e Apelit e Kosovës - Departamenti i Përgjithshëm, me aktvendimin PN1DP.nr.230/2024 të datës 20.2.2024, e ka refuzuar si të pabazuar ankesën e mbrojtësit të të pandehurit dhe e ka vërtetuar aktvendimin e shkallës së parë.

Kundër këtyre aktvendimeve, kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë ka ushtruar mbrojtësi i të pandehurit avokati Arben Shala, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe për shkak të shkeljes së ligjit penal, me propozim që Gjykata Supreme e Kosovës ta aprovojë si të bazuar kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë dhe të konstatohet e aktvendimet e kundërshtuara përmbajnë shkelje të dispozitave të procedurës penale dhe shkelje të ligjit penal.

Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit, me shkresën KMLP.III.nr.75/2024 e datës 19.3.2024, ka propozuar që kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e të pandehurit të hedhet si jolëndore.

Gjykata Supreme e Kosovës, në seancën e kolegjit shqyrtoi shkresat e lëndës në kuptim të nenit 435, paragrafi 1 lidhur me nenin 436, paragrafi 1 të KPP-së, vlerësoi pretendimet në kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë, përgjegjës në kërkesë dhe gjeti se:

- Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë është jo lëndore.

Duke pas parasysh faktin se, në bazë të shkresave të lëndës, kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë e mbrojtësit të të pandehurit, paraqitur kundër aktvendimeve të kundërshtuara, të Gjykatës Themelore në Prizren – Departamenti i Përgjithshëm, Ppr.nr.96/2024 të datës 13.2.2024 dhe aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, PN1DP.nr.230/2024 të datës 20.2.2024, në këtë gjykatë është pranuar me datë 18.3.2024, d m th pasi që të pandehurit i ka skaduar afati i caktimit të paraburgimit (paraburgimi ka qenë i caktuar nga data 11.2.2024 deri më datë 11.3.2024), andaj kjo gjykatë vlerëson se kërkesa nuk mund të jetë objekt shqyrtimi dhe si e tillë është jolëndore sepse pavarësisht shkeljeve të pretenduara në kërkesë nga mbrojtësi i të pandehurit, i pandehuri e ka mbajtur paraburgimin për atë kohë sa ka qenë i caktuar me vendimin e kundërshtuar, të cilit i ka skaduar afati.

Nga sa u parashtrua më lartë dhe në kuptim të nenit 435, paragrafi 2 të KPP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - PRISHTINË

Pml.nr.183/2024, më datë 20.03.2024

Bashkëpunëtorja profesionale
Qefsere Berisha

Kryetari i kolegjit,
Afrim Shala